



**UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ**

Rektori
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 43/20; Datë: 09.01.2020

Në bazë të nenit 49 pikë 1.3 të Statutit të Përkoħshem të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 09.01.2020, merr

V E N D I M

I.

Miratohet Rregullorja për parimet e funksionimit të Bordit Industrial në UShAF.

II.

Rregullorja hynë në fuqi nga dita e miratimit të saj.

A r s y e t i m

Senati i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore dhe rregullimit të çështjeve si: funksionimi, fushëveprimi, mënyra e vendimarjes dhe mandati i Bordit Industrial, pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Bordit Industrial të UShAF
3. Arkivit të UShAF;

Rektori

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI



**UNIVERSITETI
ISHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ**

Rektori
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 43/20; Datë: 09.01.2020

Në bazë të nenit 5, paragrafi 3 dhe nenit 49, paragrafi 1.3 të Statutit të Përkoħshém tē Universitetit tē Shkencave tē Aplikuara në Ferizaj, si dhe pér qëllim tē plotësimit tē infrastrukturës ligjore, Senati i UShAF nē mbledhjen e mbajtur më 09. 01.2020, miraton:

RREGULLORE

Pér parimet e funksionimit tē Bordit Industrial tē Universitetit tē Shkencave tē Aplikuara në Ferizaj.

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton karakterin, anëtarësimin, funksionimin, fushëveprimin, mënyrën e vendimmarrjes dhe mandatin e Bordit Industrial tē Universitetit .

Neni 1

1. Karakteri i Bordit tē Industrial (nē tekstin e mëtejmë Bordi), tē themeluar nē bazë tē Statutit tē Universitetit tē Shkencave tē Aplikuara në Ferizaj (nē tekstin e mëtejmë Universiteti) dhe tē kësaj Rregulloreje, *është jo fitimprurës dhe këshillëdhënës* dhe bazohet nē vullnetin e mirë tē anëtarëve dhe përkushtimin e Universitetit pér ngritjen e cilësisë së Arsimit tē Lartë nē fushën e veprimtarisë së tij.
2. Bordi përbëhet nga përfaqësuesit e tregut tē punës (industrisë) dhe tē autoriteteve nga fushë-veprimtaria e Universitetit.
3. Përbërja dhe aktivitetet e Bordit publikohen nē web faqen e Universitetit.

Neni 2

1. Bordin e themelon Senati i Universitetit me propozimin e Rektorit.
2. Bordi përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha ndërmarrjeve dhe institucioneve me të cilat Universiteti ka nënshkruar marrëveshje tē bashkëpunimit profesional.

3. Pas konstituimit të Bordit dhe zgjedhjes së Kryetarit, Bordit mund ti bashkohen edhe anëtarë tjerë të tij.

Neni 3

1. Bordi përbëhet nga përfaqësues të tregut të punës që janë vendimarrës në kompani private apo publike si dhe përfaqësues të autoriteteve qeveritare dhe joqeveritare relevante për fushë-veprimtarinë Universitetit.
2. Anëtarë *ex-officio* të Bordit janë Rektori (me të drejtë vote), Prorektorët dhe Dekanët e njësive akademike (pa të drejtë vote), si dhe një përfaqësues nga administrata e Universitetit (pa të drejtë vote).
3. Rektori përgatit mbledhjen konstitutive të Bordit, përpilon materialet lidhur me rendin ditës dhe ndërmerr aktivitete tjera për mbarëvajtjen e punës së Bordit .

Neni 4

1. Bordi e zgjedh Kryetarin nga radhët e përfaqësuesve të tregut të punës. Kryetari i Bordit i udhëheq mbledhjet dhe kujdeset që informatat lidhur me mbledhjet të shpërndahen te të gjithë anëtarët e vet dhe palëve tjera të interesit.
2. Bordi zgjedh edhe nënkyetarët e industrive përkatëse (5 nënkyetarë (të cilët duhet të jenë nga fushat e fakulteteve përkatëse). Këta nënkyetarë së bashku me Kryetarin e Bordit do të udhëheqin mbledhjet e me anëtarët e industrive përkatëse.
3. Sipas kësaj rregulloreje dhe praktikës së mirë dhe transparente, Kryetari i Bordit përkujdeset përmbladhjen e raporteve të punës së Bordit dhe operacionalizimin e iniciativave të tij.
4. Kryetari i Bordit e përfaqëson atë në raport me palën e tretë. Në mungesë të kryetarit, ai/ajo mund të caktojë një zëvendës të tij.
5. Kryetari i Bordit prezanton punën e Bordit në organizime të ndryshme, si: Këshilli Mësimor/Shkencorë, Senati, Këshilli Drejtues, institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, punëtori tematike, etj.
6. Bordi mund të formoj grupe punuese që përqendrohen në lëmi të veçanta të fushëveprimit të Universitetit.
7. Varësisht nga temat për diskutim, në mbledhjet e Bordit mund të ftohen Drejtorët e programeve mësimore, Drejtori i Institutit dhe përfaqësues të organeve përkatëse që funksionojnë në kuadër të Universitetit, pa të drejtë vote.

Neni 5

1. Bordi mund t'i sugjerojë Këshillit Mësimor/Shkencorë dhe Senatit përditësimin e programeve të studimeve si dhe njësive të reja akademike sipas nevojave të tregut.
2. Anëtarët e Bordit mbështesin realizimin e praktikës profesionale të studentëve të Universitetit, në pajtim me programet e studimeve.
3. Bordi mbështet Universitetin dhe tregun e punës në fushëveprimtarinë punuese në krijimin e grupeve të përbashkëta punuese.
4. Bordi dhe Universiteti bashkëpunojnë në kërkime shkencore, shërbime profesionale, bashkëpunime në projekte, ndërmjetësim përinovacione, si dhe në propozime përbashkëpuni në projekte të përbashkëta me Universitetin dhe partnerë të tjerë.

5. Anëtarët e Bordit mund të ofrojnë bursa për studentë si dhe përkrahje financiare për projekte hulumtuese të studentëve dhe stafit akademik.
6. Bordi mund të shqyrtojë edhe çështje tjera të propozuara nga Rektori.

Neni 6

1. Bordi duhet të takohet së paku dy herë në vit dhe ate së paku brenda dhjetë ditëve nga fillimi i viti akademik dhe në përfundim të tij.
2. Bordi sipas kërkesës të së pakut 15 anëtarëve mund të thirret mbledhje të jashtëzakonshme ku duhet të marrin pjesë së paku 50% e tyre. Në rast se Kryetari ose Zëvendës kryetari për ndonjë arsy nuk thërrasin mbledhjen, mbledhja mund të thirret sipas pikës 2 të këtij nenit, por që e njëjtë udhëhiqet nga anëtari më i vjetër pjesëmarrës në takim. Kjo mbledhje mund të thirret për rastin konkret vetëm njëherë.
3. Në raste të tjera kur paraqiten pengesa në thirrjen dhe organizimin e mbledhjes, këtë të drejtë mund ta ushtroj edhe Universiteti.
4. Me kërkesë të Anëtarëve të Bordit Industrial ose të Universitetit, për raste specifike mbledhja mund të thirret edhe vetëm me anëtar të industrisë brenda një programi. Me rekomandimet nga mbledhja e mbajtur, përmes e-mailit njoftohen anëtarët e tjerë të Bordit Industrial.
5. Mbledhjet e Bordit Industrial thirren së paku 3 ditë para datës së mbledhjes nga Kryetari.
6. Në rast të mungesës së Kryetarit, mbledhjet thirren nga njëri Zëvendës-kryetar i programit përkatës e në raste të tjera nga zëvendës-kryetari më i vjetër. Në çdo mbledhje të bordit Industrial nënshkruhen listat e pjesëmarrësve si dhe procesverbali nga mbledhja e mbajtur e cila nënshkruhet nga Kryetari dhe Procesmbajtësi. Materialet e mbledhjeve të mbajtura duhet të ruhen si dokumente afatgjate në Sekretarinë e Administratës së Universitetit

Neni 7

1. Bordi mund të sugjerojë ndryshimin, përmirësimin dhe amandamentimin e rregulloreve dhe akteve tjera në fuqi.
2. Bordi mund t'i propozojë Këshillit Mësimor/Shkencorë dhe Senatit programe që kanë të bëjnë me: mësim terë-jetësor, aftësimin e të rriturve dhe trajnime profesionale.
3. Bordi bënë vlerësimet, rekomandime e sugjerime lidhur me kushtet e punës, laboratorët dhe lehtësimin e funksionalizimit të punës.
4. Këshillat dhe sugjerimet e Bordit për çështjet e trajtuar, do t'i adresohen Këshillit Mësimor/Shkencorë, Senatit, Menaxhmentit dhe Këshillit Drejtues të Universitetit, në kuadër të: hartimit të programeve të reja, aplikimit për proces të akreditimit, caktimit të punës praktike, planifikimit projekteve kërkimore-shkencore, vlerësimit të tyre, hartimit të dokumenteve strategjike, etj.

Neni 8

1. Aprovimi i propozimeve bëhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
2. Rekomandimet e Bordit, në formë të propozimit dorëzohen në Këshillin Mësimor/Shkencorë për procedim të mëtutjeshëm.

Neni 9


1. Mandati i anëtarëve të Bordit zgjat 4 (katër) vite, me mundësi të rizgjedhjes. Numri i mandateve nuk është i kufizuar.
2. Me ftesën e Rektorit, Kryetari i Bordit mund të prezantojë para Senatit aktivitetet e Bordit për periudhën e caktuar.

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Rektori

Prof. Dr. Agron Bajraktari



A blue ink signature of Prof. Dr. Agron Bajraktari is written over a horizontal line. To the right of the signature is a circular blue ink stamp. The stamp has text in both English and Albanian. The outer ring of the stamp contains the text "UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES" in English and "UNIVERSITETI I SHENCAVE TË APLIKUARA" in Albanian. The center of the stamp contains the text "FERIZAJ".